



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201600239/2

Tiranë ___/___/2016

Lënda : *Rekomandojmë marrjen e masave organizative për shpejtimin e gjykimit të çështjes administrative me Nr.9641 regj.them. datë 20.05.2015, me të gjykuar A. M. nga Saranda.*

Drejtuar : Z. KASTRIOT SELITA
Kryetar i Gjykatës Administrative të Apelit
TIRANË

I nderuar zoti Kryetar,

Në ankesën e tij datë 17.02.2016, drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit, shtetasi A. M. nga qyteti i Sarandës, ankohet për zvarritje gjykimi pa shkaqe ligjore dhe shkeljen e procedurave gjyqësore nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, në gjykimin e një çështje gjyqësore.

Ankuesi Adil Malka nga ana e tij na sqaron se me vendimin gjyqësor Nr.153 datë 07.05.2015 Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastër është vendosur si vijon :

Pranimin e padisë.

Korigjimin e aktit librezë e punës me Nr.275/h 21.07.1980 të lëshuar nga Miniera e Qymyrgurit Memaliaj për periudhën 01.02.1985-31.07.1985 lidhur me llojin e punës së paditësit A.M. siç janë bërë.

Kundra këtij vendimi gjyqësor është ankuar pala e paditur Dega e Sigurimeve Shoqërore Gjirokastër, dhe dosja tani ndodhet për gjykim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, e regjistruar me Nr.9641 akti, datë 20.05.2015 dhe si relatore është caktuar Zj.Blerona HASA e cila nuk ka planifikuar akoma gjykimin e saj.

Ankuesi A. M. nga ana e tij ka kërkuar ndihmë dhe ndërhyrje nga institucioni i Avokatit të Popullit, për shpejtimin e këtij gjykimi sa më shpejt në të ardhmen duke patur parasysh se atij i është ndëprerë lidhja e pensionit të pleqërisë dhe nuk ka të ardhura të tjera për të përballuar kushtet e jetesës..

Në këto kushte dhe duke analizuar shkaqet e parashtuara para nesh nga ankuesi dhe jurisprodencën e Gjykatës Kushtetuese të RSH, si dhe kërkesat e nenit 63/3 të kushtetutës tonë ku thuhet se: "Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkeljen e të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike".

Po kështu në dispozitat ligjore të nenit 49/2 të Ligjit Nr.49/2012”Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, thuhet se:”Gjykata Administrative e Apelit shqyrton çështjen brenda 30 ditëve, nga data e ardhjes së ankimit nga gjykata ku është paraqitur ankimi. Në rastin konkret dosja e ankuesit A. ka ardhur dhe është regjistruar për gjykim me datë 20.05.2015, dhe akoma ajo nuk është caktuar për gjykim.

Ky veprim konsiderohet shkelje e procesit të rregullt ligjor edhe nga Gjykata Kushtetuese me vendimin gjyqësor Nr.81 datë 28.12.2015, duke vendosur pranimin e kërkesës së kërkuarit. Gjykata Kushtetuese arsyeton se ligji synon në thjeshtimin e procedurave me objekt zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative dhe se vet qëllimi i krijimit të gjykatave administrative, është garantimi i mbrojtjes efektive të të drejtave të subjektit dhe interesave të ligjshme të personave nëpërmjet një procesi të rregullt ligjor dhe brenda afateve sa më të shpejta dhe të arsyeshme ligjore.

Në bazë të nenit 21/b të Ligjit Nr.8454 datë 04.02.1999”Për Avokatin e Popullit”, ku parashikohet se:”Pas përfundimit të hetimit, Avokati i Popullit paraqet rekomandim për venien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrative që sipas tij, ka shkaktuar shkeje të të drejtave dhe lirive”.

Për sa më sipër, Ju

REKOMANDOJMË :

1.Marrjen e masave organizative për shpejtimin e gjyimit të çështjes administrative me Nr.9641 akti, datë 20.05.2015, me ankues A. M. nga Saranda.

2.Mbi masat e marra nga ana juaj në zbatim të këtij rekomandimi, lutemi të njoftohemi me shkrim brenda një afati prej 30 ditësh.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI

Arben SHKËMBI